

16-02-2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRË NË DORËZIM-PRIMI-JENO-RECEIVED			
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Eroj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	052	8338	L

DATE-Protokolli:	16.02.2026– Suharekë ,
PËR:	Bali MUHARREMAJ-Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet e datës 6-8 janar 2026
LËNDA:	<i>Raport pune mbi vërshimet e muajit janar 2026</i>

Të nderuar,

Nga data 6–8 janar 2026, në territorin e Komunës së Suharekës kanë rënë reshje të dendura atmosferike, si pasojë e të cilave janë shkaktuar vërshime të konsiderueshme. Si rezultat i këtyre vërshimeve, janë shkaktuar dëme në shumicën e fshatrave të komunës, si dhe në disa pjesë të qytetit të Suharekës.

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes në terren nga Komisioni Komunal i formuar për këtë qëllim, është konstatuar se dëmet më të mëdha janë shkaktuar në:

- ekonomitë familjare,
- sektorin e bujqësisë.

Vlera e përgjithshme e dëmeve të vlerësuara arrin shumën prej **117 353 87euro**.

Duke u mbështetur në gjendjen faktike të krijuar në Komunën e Suharekës dhe duke marrë parasysh kapacitetet e kufizuara financiare të buxhetit komunal për sanimin e kësaj gjendjeje, Komuna e Suharekës paraqet këtë kërkesë dhe raport pranë Komisionit Qendror për Vlerësimin e Dëmeve nga FNFT.

Komisioni është formuar në bazë të profileve të ndryshme profesionale dhe ka kryer vlerësimin e dëmeve në ekonomitë familjare dhe në bujqësi. Vlerësimi është bërë në koordinim të plot me Komisionin Qendror, duke marrë për bazë të gjitha rekomandimet e tyre, si dhe duke u bazuar në Rregulloren me Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera. Për vlerësimin e dëmeve në bujqësi është marrë për bazë Raporti i Gjelbër 2025 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Komisioni ka filluar punën më **13.01.2026**, duke shqyrtuar kërkesat e qytetarëve dhe duke inspektuar nga afër dëmet e shkaktuara në terren.

Zonat më të prekura janë ato përkatësisht:

Suhareka (qyteti), si dhe fshatrat: Peqan, Reshtan, Studenqan, Semetisht, Nishor, Njëpërbisht, Tërrnje, Leshan, Gelancë, Grejkoc, Mushtisht, Sopijë, Shirokë, Bukosh, Reqan, Sllapuzhan, Duhël, Bllacë, Maqitevë, Samadrexhë, Savrovë, Vraniq, Sallagrazhdë, Breshanc, Gjinoc dhe Greiqec.

Dëmet janë evidentuar kryesisht në ekonomitë familjare dhe në sektorin e bujqësisë.

Gjithsej janë **47 ekonomi familjare** të dëmtuara, të cilat janë të dokumentuara me raporte të detajuara. Vlera e dëmeve në ekonomitë familjare arrin rreth vlerën rreth **57 339 00 euro**.

Ndërsa në sektorin e bujqësisë, vlera e dëmeve të shkaktuara arrin në total **60 014 87 euro**.

Pjesa tjetër e dëmeve i takon infrastrukturës së përgjithshme komunale.


Bashkë me këtë raport, gjendet e bashkangjitur edhe dosja e plotë me raportet e detajuara të vlerësimit të dëmeve.

Vërejtje:

Gjatë vizitave në terren, Komisioni ka vërejtur se shumica ekonomive familjare, pas përfundimit të reshjeve, kanë filluar menjëherë me pastrimin e shtëpive dhe largimin e gjësendeve të dëmtuara nga vërshimet. Komisioni ka konstatuar dëmet nga afër, si dhe ka marrë parasysh dokumentacionin e ofruar nga qytetarët, përfshirë fotografi dhe video-incizime të realizuara gjatë ditëve të vërshimeve.

Rikapitulum:

Nr.	Përshkrimi	Nr. i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Vlera e dëmit
1.	Lista e dëmeve në ekonomitë familjare	60	47	13	57 339 00
2.	Lista e dëmeve në bujqësi	36	31	5	60 014 87
VLERA TOTALE					117 353 87

- 1) Florinda ISUFAJ-Kryesuese e komisionit 
- 2) Sami VATAJ-anëtar 
- 3) Anila HYKAJ -anëtare 
- 4) Valentina LLUGAXHIU-anëtare 
- 5) Valbona GALLAPENI 